



REPUBLIKA E KOSOVËS
Konsullata e Republikës së Kosovës në Cyrih

Cyrih, 15.01.2025

Znj. Valdete Hoti,
Kryetare e Shoqatës "Parandalo",

E nderuar znj. Valdete Hoti,

Në emër të Konsullatës së Republikës së Kosovës në Cyrih, ju shprehim mirënjohjen tonë të thellë për bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm dhe mbështetjen gjatë vitit 2024. Puna juaj përmes Qendrës "Parandalo", ka një ndikim të jashtëzakonshëm në përmirësimin e jetës së personave me nevoja të veçanta dhe në krijimin e një mjedisi më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë.

Në Konsullatën tonë, përkushtimi për të ndihmuar dhe përmirësuar qasjen për personat me nevoja të veçanta ka qenë prioritet. Në fillim të këtij viti dhe gjatë vitit paraprak, kemi ndërmarrë hapa konkretë për t'i mirëpritur më mirë personat me nevoja të veçanta, duke përfshirë instalimin e një ashensori (liffi) dhe krijimin e kushteve më të përshtatshme për vizitorët tanë, përfshirë karrocën për ta, për ta lehtësuar lëvizjen e tyre. Ne besojmë fuqimisht se ky përmirësim është jo vetëm një domosdoshmëri, por edhe një detyrim moral për të siguruar që çdo qytetar të ndjehet i mirëpritur dhe i respektuar në hapësirat tona.

Zemërgjerësia, përkushtimi dhe puna juaj për përmirësimin e kushteve për këtë kategori janë një shembull i shkëlqyer i humanizmit dhe solidaritetit që frymëzon të gjithë ne. Ndihmesa dhe angazhimi juaj kontribuojnë drejtpërdrejt në integrimin dhe fuqizimin e këtyre individëve në shoqëri.

Ju falënderojmë për përkushtimin tuaj të palodhshëm dhe për të gjitha projektet e rëndësishme që keni realizuar për të mbështetur personat me nevoja të veçanta. Shpresojmë që bashkëpunimi ynë të vazhdojë të thellohet edhe më tej në vitin 2025, me projekte dhe iniciativa të reja që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve për komunitetin tonë.

Ju dëshirojmë suksese të mëtijshme në misionin tuaj fisnik.



Me respekt dhe mirënjohje të thellë,
Vigor Berisha

Shef i Misionit
Konsullata e Republikës së Kosovës Cyrih